REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT, PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë e organeve të barazisë në një shoqëri demokratike, ku të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi duhet të respektohen;

Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit si institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

Duke vlerësuar angazhimin e Avokatit të Popullit për të kryer funksionin e tij, në përputhje me legjislacionin kombëtar, por edhe me atë ndërkombëtar (veçanërisht Parimet e Parisit dhe të Komisionit të Venecies),

Vlerëson veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2022, në drejtim të:

Inspektimit të kushteve në të cilat trajtohen shtetasit në përgjithësi dhe të miturit në veçanti në institucionet e privimit të lirisë dhe adresimin e rekomandimeve përkatëse në institucionet përgjegjëse.

Përfshirjes në faqen zyrtare të institucionit të një rubrike ku gjenden rekomandimet e pazbatuara, institucionet përgjegjëse, si dhe institucionet që nuk kanë kthyer përgjigje, në lidhje me rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit, që mundëson aksesueshmëri dhe vizibilitet nga çdo qytetar apo subjekt i interesuar, duke respektuar rregullat e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Angazhimit të Avokatit të Popullit gjatë situatës emergjente lidhur me pandeminë COVID-19.

Bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të rrjetit global të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut (GANHRI), rrjetit evropian të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut (ENNHRI), Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM), Organizatës së Ombudsmanëve Frankofonë (AOMF), Shoqatës së Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI).

Monitorimit të shtuar nga ana e Zyrës së Avokatit të Popullit në zonat kufitare dhe angazhimin me Policinë e Kufirit dhe Migracionit lidhur me gjetjet e tyre, që përforcon qasjen e Shqipërisë bazuar në të drejta ndaj azilkërkuesve.

Bashkëpunimit me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi përmes projekteve konkrete për të koordinuar dhe bashkuar përpjekjet, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen dhe parandalimin e shkeljeve.

Zhvillimit të aktiviteteve për përmirësimin e konsolidimin e njohurive të nxënësve për edukimin ligjor për të drejtat themelore të njeriut, veçanërisht të fëmijëve dhe punën e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Përfshirjes së Avokatit të Popullit në fazën e konsultimit të jashtëm për projektakte të propozuara nga ministritë e linjës, si dhe përfshirjes në procesin legjislativ për dhënien e mendimeve apo sugjerimeve për projektligje të ndryshme.

Përfshirjes në projektin e binjakëzimit të zbatuar ndërmjet Austrisë dhe Shqipërisë "Mbështetja ndaj Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri".

Zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe informuese në zyrat rajonale, me qëllim promovimin dhe nxitjen e respektimit të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve dhe promovimit të mekanizmave mbrojtës të tyre.

Trajtimit të një numri më të lartë të ankesave/kërkesave nga një vit më parë.

Kuvendi kërkon që Avokati i Popullit, për vitin 2023, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të intensifikojë reagimin institucional me vizibilitet më të shtuar në publik për rekomandimet që nuk zbatohen apo në rast mosbashkëpunimi nga autoritetet publike, me qëllim rritjen e besimit të publikut ndaj këtij institucioni kushtetues.

2. Të zgjerojë shtrirjen gjeografike të sesioneve informuese në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në rang vendi, me qëllim përmirësimin e njohurive të nxënësve për të drejtat e tyre themelore dhe punën e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e këtyre të drejtave, me qëllim rritjen e numrit të ankesave/kërkesave që vijnë drejtpërdrejt nga fëmijët.

3. Të sigurojë mekanizma të brendshëm për zhvillimin e inspektimeve/monitorimeve të seksionit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, që të mos operojë vetëm në bazë projektesh, si dhe të rrisë numrin e rekomandimeve nga ky seksion me qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

4. T'i kushtojë vëmendje të veçantë hartimit të rekomandimeve ndaj strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit si rrjedhojë e konstatimeve të vazhdueshme të mosrespektimit të të drejtave themelore të shtetasve.

5. Të zbatohet plani i masave për informimin dhe promovimin e mekanizmave mbrojtës të të drejtave dhe lirive, me fokus të veçantë shtetasit pjesë e grupeve vulnerabël dhe atyre të margjinalizuara të shoqërisë. Të zhvillohen takime të mëtejshme për të siguruar gjithëpërfshirje, si dhe të publikohet plani i masave në faqen e internetit dhe t'i dërgohet Kuvendit për dijeni.

6. T'i propozojë Kuvendit zhvillimin e seancave të posaçme dëgjimore me institucione publike për të adresuar problematika konkrete.

7. Të hartojë masa për të forcuar bashkëpunimin me organet dhe administratën e pushtetit vendor dhe të zhvillojë një mekanizëm për të rritur përgjegjshmërinë e pushtetit vendor.

8. Të hartojë masa për të forcuar bashkëpunimin me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

9. Të hartojë rekomandime në përgjigje të nevojës së identifikuar nga progresraporti i Bashkimit Evropian për të forcuar të drejta e qytetarëve për administratë të mirë.

10. Të zhvillojë aktivitete të përbashkëta me Grupin Parlamentar "Miqtë e Fëmijëve" për të informuar, edukuar dhe rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për çështjet e të miturve.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 22.6.2023.